

20/09/2021

**Produzioni Shpk**

**STATUTI**

**TITULLI I**

**EMËRTIMI – OBJEKTI – KOHËZGJATJA – SELIA**

**Neni 1**

**Emërtimi**

është aktuale një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nën emërtimin " **Produzioni**" Shpk

**Neni 2**

**Selia e shoqërisë dhe vendqëndrimi i ortakëve**

Shoqëria ka selinë zyrtare (ligjore) në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 9, Sheshi Avni Rustemi, Vila Nr.6, Apartamenti nr.4

Shoqëria, sipas modaliteteve (rrugë procedurale) ligjore, mund të krijojë filiale, agjensi, përfaqësi (zyra përfaqësimi), magazina dhe depo, degë, pika kontakti dhe zyra si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë.

Vendqëndrimi i ortakëve, përsa i përket marrëdhënieve me shoqërinë, është ai i përcaktuar në aktin e themelimit, ose më saktë në komunikimin e fundit (shpalljen) të bërë nga shoqëria.

**Neni 3**

**Objekti i shoqërisë**

Shoqëria "Produzioni" Sh.p.k" ka si objekt të sajën:

- te operoje si nje Agjensi promocioni, planifikimi e konsulence, kerkimi tregut
- drejtimi dhe shitja e aktiviteve publicitare, strategjive te marketingut ne treg, drejtimi kontraktual i sherbimeve artistike te cdo lloj natyre, prodhimit fotografik, diskografik dhe video kinematografike (prodhim audio-viziv publicitar, dokumentare, rubrika televizive etj.)
- Organizimi i eventeve publike dhe private, konferencash, pritjesh, konkurse bukurie, subjekt konkurses dhe cmimesh sezonale, konkurse te tjera e manifestime, si edhe aktivite si agjensi ndermjetesimi. Dhenie, lenie me qera asetesh sherbimi dhe konsumi, ndermjetesimi i asetëve me qera, lenia dhe dhenia me qera afatshkurter dhe afatgjate e autoveturave, anijeve, helikoptereve, aeroplaneve, shtepive, vilave, objekte luksi dhe jo si fustane, ora dore etj. Organizimi i cateringut ne seli fikse apo te perkohshme, dhe show room per ekspozime eventesh;
- Konsulence dhe organizim direkt ne cdo fushe sherbimi 2 brenda natyres se aktivitetit brenda kufijve te lejuar nga ligji, marrje dhe dhenie licencash te shfrytezimit tregtar, zhvillimit te hapësirës se punemarrjes ndermjet subjekteve e enteve private. Mund te marre dhe jape ndermjet agjensive, komisione, perfaqesime me apo pa depozite, perdorim dhe transferim patentash, licencash Know How dhe te drejtash pronesia intelektuale.
- Drejtimi dhe/ ose hapja e shkollave private te cdo niveli formimi o grade, publikimi i librave, revistave, periodike dhe manual specializimi, realizimi i rubrikave dhe faqeve ne internet, organizimi i kurseve te formimit profesional, personal dhe menaxherial, video kurse etj. Blerja, shitja, shkembimi dhe drejtimi i te mirave te paluajtshme, civile dhe industriale, qiradhenia dhe qiramarrja e te mirave te paluajtshme edhe me qira financiare leasing, strukturimi dhe ristrukturimi si pronesi por edhe si komision per te trete te te mirave si dhe ndarje terrenesh (lotting).

- Import-eksport automjetesh, i makinerive industriale etj. Shoqeria, ne perputhje me objektin e saj social, mund te zhvilloje te gjitha operacionet tregtare, industriale, ekonomike, mobiliare dhe imobiliare, si edhe te jape garanci, licence, depozita, pjesemarrje ne shoqeri te tjera, te perdore cdo mjet financimi nga institucione financiare si banka, institute financimi, shoqeri private etj.

Shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme per zbatimin e objektit te shoqerise dhe midis te tjerash:

- Te kryeje veprime tregtare dhe industriale, financiare, hipotekore dhe pasurive të patundshme duke perfshire blerjen, shitjen dhe shkëmbim e pasurive te patundshme te luajtshme, edhe te regjistruara, pasurive të paluajtshme dhe të drejtave pasurish te paluajtshme, qiramarrje dhe me qiradhenie aktive dhe pasive të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, me përjashtim e qirave aktive
- Te zbatoje cdo formë të financimit ( si dhe leasing-ut pasiv) me institutet e kredive, bankave, shoqerive dhe privateve, duke dhene garancitë e nevojshme reale dhe personale;
- Te japë garanci bankare, kambiale dhe garanci reale në favor të shoqerive kontrolluese, te kontrolluara dhe te lidhura dhe te kontrolluara nga nje e vetme qofte edhe ne brendesi te te njejtit grup;
- Të marri pjesë në konsorciume ose grupime shoqerish dhe asociim te perkoheshem shoqerish;
- Të marrë pjesëmarrje dhe fitime ne shoqeri e ndermarrje sipas dispozitave ligjore gjithnje ne funksion te qellimeve te shoqerise, por jo ne menyre ekskluzive.
- Shoqeria mund te perdore perfitimiet fiskale, shoqerore dhe financiare te parashikuara sipas ligjeve ne fuqi me ndryshimet e tyre, shtyrjet dhe modifikimet, per aktivitetin ne objekt, si dhe nga cdo ligj tjeter lehtesues, si dhe lehtesimet e parashikuara nga Komuniteti Europian.

#### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja (jetëgjatësia) e shoqërisë**

Jetëgjatësia e shoqërisë është e përcaktuar mbi 10 vjet, pa përjashtuar zgjatjet ose shkrirjen e parakohshme të miratuara nga Asambleja e Ortakëve.

### **TITULLI II**

### **KAPITALI I SHOQËRISË DHE PJESMARRJA E ORTAKËVE**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali i shoqërisë dhe kuotata e pjesmarrjes.**

Kapitali i shoqërisë është 10,000 (dhjete mije) Lek dhe është i ndarë në kuota ashtu siç parashikohet në Aktin e Themelimit; i cili mund të shtohet ose pakësohet me vendim të posaçëm të asamblesë së ortakëve dhe kontributet mund të bëhen në natyrë ose shkëmbime financiare.

Të drejtat mbi shoqërinë u përkasin ortakëve në përputhje me masën proporcionale të pjesmarrjes që diponon secili ortak.



## **Neni 6** **Tranferimi i kuotave.**

Ne rast se njeri nga ortakët vdes, asambleja e ortakëve duhet të vendose nëse do të mireprese trashëgimtarët si ortakë apo do t'u liqullojë (blejë) atyre këto pjesë me një vlerë të barabartë me gjendje pasurore kontabel neto e cila rezulton nga bilanci i fundit i aprovuar.

Tranferimi i pjesëmarrjes midis të gjallëve, nga ana tjetër, duhet të ndodhë vetëm në favor të subjekteve dhe individëve për të cilët asambleja, me shumicë të kapitalit të shoqërisë, të këto dhënë pelqimin e saj.

Ortaku i cili ka ndermend të shesë pjesën e tij të tretëve, jo ortakë, pasi të këto marrë pelqimin nga asambleja e ortakëve duhet t'ua ofrojë këto pjesë për shitje ortakëve të tjerë të shoqërisë në pjestim me kuotën që secili prej tyre posedon, duke i dhënë atyre të drejtën të blerjes zëvendësuese e cila do të ushtrohet brenda një periudhe prej 30 ditësh nga komunikimi i ofertes.

Trasferimi i kuotave duhet të kryhet me akt noterial.

## **TITULLI III** **VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

### **Neni 7** **Vendimet e ortakëve**

Ne baze të nenit 82 Ligj n. 9901 date 14/04/2008 ortakët vendosin përmes " Asamblesë së Përgjithshme (me poshtë do t'i referohemi si "Asamblese se Ortakëve ") në rastet e parashikuara nga Ligji dhe çdo herë që vullnet për të mbrojtur interesat e shoqërisë, dhe në mënyrë të vecantë në mbeshtetje të këtij statuti, mbi çështjet e mëposhtme të cilat u janë rezervuar atyre si kompetenca:

- modifikimet e statutit;
- vendimet për të ndermarrë operacione që kanë të bëjnë me modifikimin e objektit të shoqërisë ose një modifikim të të drejtave të ortakëve;
- vendimet e lidhura me shpërndarjen e fitimeve;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- aprovimin e bilancit të periudhës ushtrimore;
- vënien në likuidim të shoqërisë;
- çdo vendim tjetër për të cilin të paktën njeri prej administratorëve të kërkojë rezolutën e Asamblesë.

Ne baze të nenit 88 Ligj 9901 date 14/04/2008 asambletë mund të mbahen edhe në audio – videokonferencë ose edhe vetëm në audiokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesëmarrjes si më poshtë:

- duhet të zgjidhet një vend ku të jenë të pranishëm presidenti dhe sekretari i mbledhjes.
- Duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje;
- duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuara si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistenca reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.



Në rastin kur asamblea duhet të mbahet në audio – videokonferencë ose në audiokonferencë , në lajmërimin e thirrjes duhet të përcaktohet ora e fillimit të lidhjes telematike dhe vendet e audio – video konferencës të lidhura nën kujdesin e shoqërisë të cilëve do t'i bashkohen pjesmarrësit: në cdo vend mbledhjeje duhet të mbahet një procesverbal i pjesmarrjes.

### **Neni 8** **Efikasiteti i vendimmarrjes së asamblesë**

Asambletë e formuara dhe të thirrura rregullisht përfaqësojnë të drejtën universale të ortakëve dhe vendimet e marra në përputhje me ligjin dhe me aktin në fjalë i detyron të gjithë ortakët edhe ata të munguar ose kundërshtues me përjashtim të atyre që kanë përdorur të drejtën e tërheqjes sic parashikohet në ligj.

### **Neni 9** **Thirrja dhe vendi i Asamblesë**

Asambleja e ortakëve, e cila mund të mbahet si në selinë e shoqërisë ashtu edhe në vend tjetër do të thirret nga organi administrativ përmes një lajmërimi të dërguar ortakëve, këshilltarëve dhe anëtarëve të organit të kontrollit , nëse ata janë emëruar të paktën tetë ditë përpara datës së fiksuar për mbledhjen në adresën të cilën cdo i interesuar i ka dhënë shoqërisë.

Lajmërimi i thirrjes duhet të përmbajë përshkrimin e ditës , orës dhe vendit ku do të mbahet mbledhja si edhe argumentet mbi të cilat asamblesë i kërkohet të marrë vendime.

Në të njëjtin lajmërim mund të fiksohet për një ditë tjetër një mbledhje e dytë në rast se e para nuk do kishte pjesmarrje apo nuk do të mund të formohej rregullisht.

Në bazë të nenit 83 Ligj 9901 datë 14/04/2008 lajmërimi mund të redaktohet në cdo lloj forme qoftë në letër apo elektronik dhe mund të dërgohet me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë sigurohet se mund të provohet marrja e këtij njoftimi.

Ndërhyrja dhe përfaqësimi në asamble

Mund të ndërhyjnë në asamble të gjitha ata që rezultojnë të jenë ortakë në datën e asamblesë.

Cdo ortak mund të përfaqësohet përmes një prokure të shkruar të dorëzuar ose me fax ose me postë elektronike nga një person tjetër i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht ortak.

Prokura nuk mund të lëshohet e pashkruar.

### **Neni 11** **Presidenti i asamblesë**

President i asamblesë është ose administratori i vetëm ose nga presidenti i këshillit të administrimit, në rastin e emërimit nga një organ kolegjal ose në mungesë të tyre nga një person i përzgjedhur nga asambleja.

Për të arritur tek kjo përzgjedhje mbledhja duhet të drejtohet përkohësisht nga personi me moshën më të madhe i cili është i pranishëm në asamble.

Asambleja zgjedh sekretarin dhe nëse është e nevojshme dy komisioner.



Ne mbashtetje nenit 90 Ligj 9901 date 14/04/2008 vendimet e asamblesë duhet të paraqiten në një procesverbal të firmosur nga presidenti dhe sekretari i; dhe në rastet e parashikuara me ligj, procesverbali duhet të redaktohet nga noteri.

Presidenti i asamblesë verifikon rregullsinë e mbajtjes së asamblesë, certifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishëmve, rregullon zhvillimin e saj dhe certifikon rezultaten e votimeve.

#### **Neni 12 Vendimet e asamblesë**

Mbeshtetur ne nenin 86 te Ligjit 9901 te dtes 14/04/2008, Asamblea ngrihet rregullisht me prezencen e shumices se orakeve qe perbejne me shume se 30% te kapitalit te shoqerise. Ne rastet e parashikuara nga neni 87 I Ligjit 9901 te dates 14/04/2008 dhe per kete vendimet qe lidhen me modifikimet e statutit, per veprimet e shtimit apo reduktimit te kapitalit, shperndarjes se fitimive dhe riorganizimit apo shuarjes se shoqerise, asambleja konsiderohet e mbledhur ne menyre te rregullt nese ne te jane present shumica e ortakeve qe perbejne me shume se 50% te kapitalit te shoqerise. Nese nuk arrihet kuorumi I parashikuar nga neni i meparshem 12.1 asamblea duhet te rimblidhet brenda 30 diteve.

Pervec rasteve ku ligji apo statute parashikon ndryshe, asambleja e mbledhur rregullisht , merr vendime me voten pro te ortakeve qe perbejne me shume se 50% te kapitalit te shoqerise .

Për më tepër, mbi vendimet e parashikuara ne nenin 87 te ligjit 9901 te dates 14/04/2008 asamblea vendos me voten pro te me shume se 75% ortakeve.

### **TITULLI IV ADMINISTRIMI DHE PERFAQESIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 13 Administrimi i shoqërisë**

Bazuar ne nenin 95 te Ligjit 9901 te dates 14/04/2008, shoqëria administrohet , në varësi të asaj që vendoset herë pas here nga asambleja e ortakëve , nga një administrator i vetëm ose nga një këshil administrativ i përbërë nga dy ose pesë anëtarë , të emëruar edhe midis atyre të cilët nuk janë ortakë.Mbeshtetur ne nenin 95 pika 5 te ligjit 9901 date 14/04/2008, ne rastin kur shoqeria do te administrohet nga me shume se nj administrator i vetem, ne formen e keshillit te administrimit apo jo, administratorët mind te veprojne ne menyre te pavarur nga njeri tjetri.

Kohëzgjatja në detyrë e administratorëve eshte 5 vjecare e rinovueshme. Ne cdo rast, ne cdo moment domethne edhe para perfundimit te mandatit administratorët mund te revokohen edhe pan je shkak.

Shpërblimi dhe pjesmarrja në fitime e administratorit të vetëm dhe anëtarëve të këshillit administrativ përcaktohen nga ortakër.

Administratorit të vetëm ose anëtarëve të këshillit administrativ, u takon gjithashtu edhe rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsye të detyrës së tyre.



Shpërblimi i administratorëve të veshur me detyra të posacme, dhe gjithsesi të ndonjë administratori të deleguar , përcaktohet nga këshilli administrativ.

#### **Neni 14**

#### **Presidenti, zëvendës presidenti dhe administratori i deleguar**

Në rastin e emërimit të një këshilli administrativ, nëse nuk e kanë bërë ortakët, ky i fundit zgjedh midis anëtarëve të tij presidentin, zv.presidentin i cili zëvendëson presidentin në rast mungese ose pamundësie të tij me fuqitë dhe kufizimet të përcaktuar kohë pas kohe nga këshilli administrativ.

#### **Neni 15**

#### **Vendimet e këshillit administrativ**

Vendimet e këshillit administrativ merren me mledhje kolegjiale.  
Vota nuk mund të jepet përmes përfaqësimit.

#### **Neni 16**

#### **Mbledhja kolegjiale e këshillit administrativ.**

Këshilli administrativ do të mbledhet në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjetër në Shqipëri ose jashtë, cdo herë që presidenti do ta quajë të nevojshme dhe kur do të kërkohet me shkrim nga të paktën dy prej anëtarëve të tij ose nga organi i kontrollit nëse kemi një të tillë të emëruar.

Si rregull thirrja do të bëhet përmes lajmërimit me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë që mund të provohet marrja e kësaj thirrje përmes atij sistemi, këshilltarëve të paktën shtatë ditë para datës së përcaktuar për mbledhjen me përjashtim rasteve urgjente kur lajmërimi duhet të dërgohet të paktën tre ditë para mbledhjes.Në të njëjtat terma lajmërohen edhe anëtarët e organit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar.

Këshilli administrativ mund të mbahet rregullisht dhe të quhet akt vendimmarrës edhe në mungesë të formaliteteve të sipërpërmendura , nëse në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij dhe anëtarët e oranit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar , pa anashkuar të drejtën e secilit pjesmarrës për të kundërshtuar diskutimin e argumenteve mbi të cilat konsideron se nuk është informuar mjaftueshëm.

Mbledhja mund të mbahet edhe në audio – videokonferencë ose edhe vetëm në audiokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesmarrjes si më poshtë:duhet të zgjidhe një vend ku të jenë të pranishëm të paktën presidenti dhe sekretari i mbledhjes, duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje, duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuara si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistenca reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

Mënyra e deklarimit të votës nuk duhet të anashkalojë faktin se në cdo rast duhet të jenë mënyra që lejojnë evidentimin e atyre që japin vota kundër ose abstenojnë , vendosen me shumicën absolute të votave të të pranishëmve.

#### **Neni 17**





## **Vendime të marra me mbledhje kolegjale**

Këshilli administrativ merr vendime të vlefshme me shumicë absolute të votave të anëtarëve të saj; në rast barazie të votave mbizotëron vota e presidentit për sa kohë këshilli të përbëhet prej më shumë se dy anëtarëve.

Vendimet e këshillit duhet të konstatohen nga verbal i transkriptuar në një libër të posacëm të mbajtur sipas normave ligjore dhe nënshkruar nga presidenti dhe sekretari i mbledhjes.

### **Neni 18**

#### **Fuqitë e organit administrativ**

Bazuar ne nenin 95 te Ligjit 9901 date 14/04/2008 organi administrativ është i veshur me fuqitë më të gjera të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të administrimit, me përjashtim të atyre që ky akt i rezervon si kompetenca ekskluzive të vendimeve të ortakëve.

Këshilli i administrimit ose administratori i vetëm do të ketë pra, ndër të tjera, të drejtën për të blerë, shkëmbyer, shitur pasuri të tundshme dhe të patundshme, automjete, ti përfshijë në shoqëri, të marrë aksione dhe interesa, të marrë dhe obligacione, të emerojë prokurues për akte ose kategori aktesh , drejtorë e cdo gjë tjetër që do të konsiderohet e domosdoshme për qëllimet e shoqërisë.

Në rastin kur shoqëria administrohet nga një këshill, këshilli mund të delegojë një pjesë ose të gjithë atributet dhe fuqitë e tij dhe ato të presidentit , përfshirë edhe firmën e shoqërisë , njërit ose më shumë prej anëtarëve të tij duke mirëpërcaktuar atributet ose penalitetet si edhe shpërblimet në kufijtë dhe format që ai do ta gjykojë të përshtatshme.

### **Neni 19**

#### **Firma dhe përfaqësimi i shoqërisë**

Përvec rasteve të parashikuar në artikullin e mëparshëm 18.3 , firma dhe përfaqësimi i shoqërisë i takojnë administratorit të vetëm ose presidentit të këshillit administrativ.

## **TITULLI V ORGANI I KONTROLLIT**

### **Neni 20**

#### **Organi i kontrollit.**

Kontrolli i shoqërisë mund t'i besohet dhe të kryhet sipas zgjedhjes dhe me vendim të pronarëve nga një ekspert kontabël. Eksperti kontabël mund gjithashtu të pushohet nga puna nga asambleja e ortakëve.

## **TITULLI VI BILANCI – FITIMET**



**Neni 21**  
**Ushtrimi i shoqërisë, bilanci dhe fitimet.**

Ushtrimet e shoqërisë mbyllet më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të cdo viti. Ushtrimi i parë mbyllet më 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2021 (dymijë e njetzet e nje) .

Bilanci i hartuar në konformitet me normat e patjetërsuara ligjore, duhet tu paraqitet ortakëve për miratim brenda afatit të 31 Marsit të cdo viti, përveç mundësive kur mund të ketë një afat më të gjatë brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara me ligj.

- Fitimet neto të rezultuara nga bilanci do të ndahen kështu:
- 5 % (pesë për qind) në ngritjen e një fond rezerve ligjore, deri në arritjen e një shume të barabartë më një të pestën e kapitalit të shoqërisë;
- Fitimi i mbetur do të shpërndahet ose do të lihet mënjanë në varësi të vendimeve të ortakëve që aprovojnë bilancin.

Në cdo rast, nëse verifikohet humbje kapitali, nuk mund të ketë shpërndarje fitimesh deri kur kapitali i shoqërisë të riintegrohet dhe të kthehet në masën e duhur.

**TITULLI VII**  
**SHKRIRJA, PERJASHTIMI I ORTAKEVE, LIKUJDIMI DHE MOSMARRVESHJET**

**Neni 22**  
**Shkrirja**

Shoqëria quhet e shkrirë vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.


Në cdo rast shkrirje të shoqërisë, ortakët do të përcaktojnë një ose më shumë likujdues dhe do caktojnë fuqitë dhe shpërblimin e tyre.

**Neni 23**  
**Dispozita të përgjithshme**

Për gjithcka që nuk është shprehimisht e parashikuar në aktin e themelimit ose në këtë statut, do të bëhet kohë pas kohe një referim i shprehur i ligjeve në fuqi.

**PRODUZIONI SHPK**

**STEFANIA NOBILE**



PERKTHYER NGA  
IZMIRJOLA MUSHO

